



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA • VLADA • GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	Nr. Prof. Br. Prof.
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	Datumi Datum: Date:
02	181
19	06.02.26
PRISHTINE/A	
NO.1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA E EKONOMISË

PLANI PËR INTEGRITET

I PËRDITËSUAR

(2026)

Prishtinë, janar 2026

PËRMBAJTJA

1. Deklarata e Integritetit.....	1-2
2. Hyrje.....	3
3. Qëllimi i Përditësimit të Planit të Integritetit.....	4
3.1 Zhvillimi i Përditësimit të Planit të Integritetit (PI).....	4-5
4. Fushëveprimtaria e Ministrisë së Ekonomisë (ME).....	5
4.1 Misioni.....	5
4.2 Përgjegjësitë e Ministrisë së Ekonomisë (ME).....	5-6
5. Metoda e vlerësimit të rrezikut.....	7
5.1 Matrica.....	7-8
6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit (PI).....	9
7. Fushat e rrezikut.....	10
7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut.....	10
7.2 Fushat e veçanta të rrezikut.....	10
Fushat e përgjithshme /Matrica.....	11-15
Fushat e veçanta/ Matrica.....	16-19

1. DEKLARATA E INTEGRITETIT

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklaratë gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikën, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), (Gazeta Zyrtare Nr. 19, datë 21.07.2022), nenit 25 të ligjit, të gjitha organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Republikës së Kosovës obligohen që të miratojnë Planin e Integritetit (PI).



Plani i Integritetit (PI), synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate publike profesionale dhe të modernizuar, zhvillim të qëndrueshëm socio – ekonomik, duke arritur kështu ngritjen e cilësisë së politikave dhe shërbimeve efektive për të gjithë qytetarët. Plani i Integritetit (PI), është një dokument që tregon përkushtimin e Ministrisë së Ekonomisë (ME), ndaj zbatimit të planit të integritetit dhe përcakton politikën dhe procedurat që do të përdoren për të arritur këtë qëllim.

Ministria e Ekonomisë (ME), ka për mision të hartoj dhe zbatoj politika të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja në energji, miniera dhe sektorin e TIK-ut si dhe të garantoj konkurrencën në një treg të sigurtë e të qëndrueshëm të burimeve energjetike e minerale të vendit, zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe teknologjisë informative, si dhe krijim të politikave dhe monitorimit të Ndërmarrjeve Publike. Këto do të arrihen përmes hartimit dhe zbatimit të politikave, strategjive, planeve, programeve dhe projekteve, dhe përmes Planit të Integritetit (PI), Ministria e Ekonomisë (ME) synon të promovoj llogaridhënien, transparencën dhe integritetin në mënyrë që të përmbushen objektivat e saj për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike. Plani i Integritetit (PI) i është përshtatur nevojave specifike të ME-së, në përgjithësi, përfshinë elementët e mëposhtme: vlerësimin e rreziqeve aktuale të integritetit të ministrisë, një tërësi qëllimesh dhe objektivash për Planin e Integritetit (PI), politikën dhe procedurat për të adresuar rreziqet e integritetit, si dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimin e efektivitetit të Planit të Integritetit (PI). Plani i Integritetit (PI) do të ndihmoj në rritjen e besimit të publikut dhe palëve të treta të përfshira në aktivitetet e punës së ME-së, do të ndihmoj në parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe integriteti ndihmon për të siguruar përputhjen me aktet ligjore dhe aktet nënligjore.


Plani i Integritetit (PI) përveç që është kërkesë ligjore, është gjithashtu instrument thelbësor për Ministrinë e Ekonomisë (ME), që të ruajë integritetin e saj të përmirësoj vazhdimisht reputacionin dhe të mbrohet nga mashtrimi, korrupsioni dhe lëshime të tjera në fushën etike. Në këtë kuadër, theksohet se Plani i Integritetit 2024–2026 është përditësuar dhe finalizuar vetëm për vitin 2026, ndërsa kjo Deklaratë e Integritetit i

bashkëngjitet Planit të përditësuar pas miratimit të tij, si pjesë përbërëse e dokumentacionit përkatës.

Andaj, ne besojmë që ky Plan i Integritetit (PI), do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'iu forcohet besimi ndaj institucionit, dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda ministrisë.

Unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë, zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Ministrisë së Ekonomisë (ME).

Leonita Shabani – Mullarama



Sekretare e Përgjithshme

2. HYRJE

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 25, Ministria e Ekonomisë ka përditësuar Planin e Integritetit për vitin 2026, pjesë e Planit të Integritetit 2024–2026. Ky përditësim realizohet çdo vit për të siguruar që masat e integritetit brenda institucionit mbeten të efektshme, të përditësuara dhe të përshtatura me ndryshimet ligjore, organizative dhe zhvillimet e reja.

Përditësimi garanton që Plani të mos mbetet një dokument formal, por një udhëzues aktiv që kontribuon në parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional. Procesi mbështetet në monitorimin e masave ekzistuese, identifikimin e rreziqeve të reja dhe rekomandimet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Përgjegjës për koordinimin e përditësimit është Zyrtari për Integritet, në bashkëpunim me njësitë përkatëse dhe me mbikëqyrjen e titullarit të institucionit.

Ky dokument përshkruan procedurat dhe hapat konkretë të përditësimit të Planit të Integritetit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, analizën e rreziqeve, hartimin e ndryshimeve, konsultimin e brendshëm, shqyrtimin nga Agjencia, miratimin dhe publikimin, si dhe mënyrën e evidentimit të versioneve të planit.

3. QËLLIMI I PËRDTËSIMIT TË PLANIT TË INTEGRITET

Përditësimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 hartohet në fund të çdo viti kalendarik dhe ka për qëllim krijimin e:

- Sistemit efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënies publike dhe transparencës;
- Rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikimit të menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion;
- Mundësive që Ministria e Ekonomisë (ME), të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Masave për identifikimin dhe zvogëlimin e rreziqeve;
- Kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuar;
- Një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;

Në vazhden e përkushtimit për zbatimin e Planit të Integritetit 2024-2026, Ministria e Ekonomisë ka përditësuar planin. Kjo kontribuon për një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara, përfshirë shërbime dhe politika të përmirësuara për qytetarët dhe grupet e interesit. Gjithashtu, ministria do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara.

3.1 Zhvillimi i Përditësimit të Planit të Integritetit (PI)

Plani i Integritetit (PI) është zhvilluar në disa hapa si në vijim:

Procesi i përditësimit të Planit të Integritetit ka filluar më datën 06.11.2025 duke dërguar njoftimin tek njësitë e brendshme nga Zyrtari përgjegjës për Zbatimin dhe Monitorimin e Planit të Integritetit, i cili ka informuar për nisjen e procesit të përditësimit dhe ka dërguar kërkesë për informacione lidhur me masat e zbatuara, vështirësitë e hasura dhe propozimet për ndryshime.

Në vijim, me datën 08.12.2025 janë dërguar materiale udhëzuese të pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit tek secila njësi, ku më pas ato kanë përgatitur raporte mbi ecurinë e masave, duke u bazuar në matricën standarde të monitorimit dhe raportimit, me ç'rast janë evidentuar masat e përfunduara ose ato që kanë rezultuar joefektive.

Më pas, në fillim të janarit janë rishikuar fushat e rrezikut dhe është bërë analiza e nevojës për shtim, heqje apo ndryshim të rreziqeve dhe masave ekzistuese, me qëllim rritjen e efektivitetit të Planit të Integritetit.

Në bazë të kësaj analize, më datë 19.01.2026 është mbajtur takimi final ku janë përgatitur masa të reja dhe janë bërë ndryshime në masat ekzistuese, duke u përditësuar matrica në përputhje me nevojat reale institucionale.

Pas përfundimit të konsultimeve të brendshme, me datë 27.01.2026 drafti i përditësuar i Planit është përcjellë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për komentim dhe verifikim të përputhshmërisë me udhëzuesin përkatës.

Pas reflektimit të komenteve të Agjencisë, titullari i institucionit e ka miratuar Planin e Integritetit të Përditësuar me datë 06.02.2026.

Plani i përditësuar është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe një kopje i është dërguar Agjencisë për arkivim.

4. FUSHËVEPRIMTARIA E MINISTRISË SË EKONOMISË (ME)

4.1 Misioni

Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës përgatit dhe zbaton politika, hartimin e akteve ligjore, miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme, të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja, garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurt, sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike e minerare të vendit, sigurojnë zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe teknologjisë informative, si dhe garantojnë efikasitet në administrimin e Ndërmarrjeve Publike (NP).

4.2 Përgjegjësitë e Ministrisë së Ekonomisë (ME):

- Përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, zbatimin e tyre, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e energjisë, minierave, sektorit postar, telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe ekonomisë digjitale duke siguruar përfrimin me Acquis të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse;

- Zbaton politikat publike dhe legjislacionin në fushën e energjisë, minierave, sektorit postar, telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe ekonomisë digjitale në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Mbështet zhvillimin e ekonomisë së tregut, liberalizimin e tregut në shërbimet publike dhe futjen e kapitalit privat në atë publik;
- Përgatitë analiza periodike të tregueseve ekonomike dhe vlerësimin ekonomik të politikave publike, si dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave/strategjive të zhvillimit ekonomik dhe sektorial;
- Ndhmon Qeverinë e Republikës së Kosovës (QRK) në ushtrimin e të drejtave të aksionarit dhe kryeson Komisionin Ministror (KM) për Ndërmarrje Publike (NP);
- Mbikëqyrë dhe vlerëson Bordet e Drejtorëve (BD) të Ndërmarrjeve Publike (NP) sipas legjislacionit;
- Siguron zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe Planin Kombëtar për Eficiencë të Energjisë dhe monitoron Planet Komunale për Eficiencë të Energjisë (PKEE);
- Monitoron sistemet e energjisë, duke përfshirë trajtimin e situatave emergjente të cilat lidhen me sigurinë e furnizimit me energji dhe promovon zbatimin e rregullave dhe standardeve teknike në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Përmes Inspektoratit për Energji bën mbikëqyrjen administrative të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore për energji, pajisje nën presion dhe eficiencë;
- Bashkërendon aktivitetet lidhur me negocimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare brenda fushës së përgjegjësisë administrative të saj;
- Promovon dhe përfaqëson sektorin mineral brenda dhe jashtë vendit;
- Kryen hulumtime gjeologjike dhe në bashkëpunim me autoritetet tjera publike dhe institucionet përkatëse, në mënyrë sistematike bën mbledhjen, arkivimin, kompilimin, përpunimin, si dhe i vë në dispozicion të dhënat gjeoshkencore përkitazi me resurset gjeologjike të Republikës së Kosovës dhe me kërkesë të Qeverisë i siguron raportet që i ka në dispozicion dhe vlerësimet e ekspertëve lidhur me çështjet gjeoshkencore;
- Zhvillon dhe përkrah sektorin e TIK-ut, në veçanti, tregtinë elektronike, identifikimin elektronik, sigurinë e sistemeve të informacionit, Inteligjencën Artificiale (IA), si dhe teknologjitë tjera të reja (Internet of Things, Big Data, Cloud Computing, Virtual Reality, 3D Printing etj.).

5. Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike. Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e ministrisë dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të institucionit.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët, i mesëm, i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku janë më se të nevojshme.

5.1 Matrica e vlerësimit të rrezikut

[illegible]

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intensiteti i rrezikut (gjasat X ndikimi).	i	Ulët			Mesatar				Lartë		
		Probabiliteti/Gjasat									

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, “ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)”, treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga një (1) deri në njëqind (100), si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

6. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të përditësuar të Integritetit

Zbatimi i Planit të Përditësuar të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK).

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi përcakton nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut, si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt do të siguroj se zbatimi i planit bëhet në përputhje me afatet kohore dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Pas hartimit të raportit për zbatimin e Planit të Integritetit (PI) nga zyrtari përgjegjës brenda ministrisë, raporti do të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK).

Raportimi bëhet në kontekstin konkret nëse masat e paraqitura janë zbatuar në kohën e duhur, pas afatit apo në mënyrë periodike.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të Planit të Integritetit (PI) krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit (PI), si në vijim:

- ✓ përgatitjen e programit për zhvillimin e Planit të Përditësuar të Integritetit;
- ✓ siguron që Plani i Integritetit i Përditësuar monitorohet në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës, metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;
- ✓ zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;
- ✓ propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- ✓ sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të, si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planin e Përditësuar të Integritetit;

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Fusha e menaxhimit financiar;
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Komunikimi dhe informimi/transparenca;

7.2 Fushat e veçanta të rrezikut janë:

- Rreziku financiar;
- Menaxhimi i projekteve/kontratave.

Nga përditësimi i Planit të Integritetit 2024-2026, për vitin 2026, 1 masë është larguar, 3 masa janë ridestinuuar dhe 2 masa janë shtuar.

Planit i Përditësuar i Integritetit (PPI) për vitin 2026

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut		Masat ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut.	Përshkrimi i rrezikut.	Masat ekzistuese të kontrollit.	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve.	Njësia/zyrtari përgjegjës.	Afati i realizimit.
Korniza ligjore	Ridestitim 1. Mosrealizimi i kornizës ligjore të planifikuar të institucionit.	Programi legjislativ dhe plani i akteve nënligjore	6	6	36	Ruhet masa për tu realizuar gjatë vitit 2026. 1.1 Përfundimi me kohë i kornizës ligjore të planifikuar. 1.2.Koordinimi dhe bashkëpunimi me njësitë/departamentet përkatëse të ME-së deri në dorëzimin përfundimtar	Grupet Punuese (GP), njësitë e ME-së dhe konsulentat.	TM4 2026

									te aktit per shqyrtim dhe miratim. 1.3. Finalizimi i akteve sipas afateve të përcaktuara në Programin Legjislativ dhe në Planin e akteve nënligjore.				
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizimi Institucional	Ridestinin 1.Vonesa në rishikimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe ndërrimi i pozitave të punës mund të ndikojnë negativisht në shpalljen e procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhja e kandidatëve jo-adekuat për pozitat e vakante. 2. Mungesa e trajnimeve të avancuara sipas kërkesave specifike nga njësitë përkatëse.	Ligji për zyrtarët publik, Ligji i pagave, dhe aktet tjera normative	3	5	15	Ruhet masa për tu realizuar gjatë vitit 2026. 1.1 Përfundimi i Projekt-Rregullores nga komisioni për hartim dhe miratimi i saj. 1.2 Plotësim ndryshimi i vendeve të punës në përputhje me strukturën organizative të Institucionit. Miratimi i përshtkrimeve të punës nga ZKA.	NjMBNj, DL, ZKA, Departamentet/ Agjencitë, DMZP/MPB, IKAP, MFPT,	TM4 2026					

Transparenca dhe llogaridhënia publike	Ridestitim 1. Vonesat në përgjigje ndaj gazetarëve dhe në kërkesa për qasje në dokumente publike. 2. Ankesat në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP).	Ligji për qasje në dokumente publike	5	8	40	1.3 Realizimi i Planit të Personelit për vitin 2026. 1.3 Inicimi dhe përmbyllja e proceduarve për rekrutim dhe përdorimi i mekanizmave alternativ, si programi YCS dhe angazhimi i praktikantëve; 2.1. Identifikimi dhe realizimi i planit të trajnimeve. 2.2 Dërgimi i kërkesës në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.	Të gjitha njësitë brenda ME-së/DKP.	TM4 2026
--	---	--------------------------------------	---	---	----	---	-------------------------------------	----------

Planit i Integritetit (PI)

Fushat e veçanta të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut.			Veprimi ndaj rrezikut.			
Fusha e rrezikut.	Përshkrimi i rrezikut.	Masat ekzistuese të kontrollit.	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat propozuara për zvogëlimin e rreziqeve.	Njësia/zyrtari përgjegjës.	Afati i realizimit.
Menaxhimi i Prokurimit	1. Rreziku i dështimit të projekteve kapitale si pasojë e vonesave në iniciimin e kërkesave dhe hartimin e Termave të Referencës (ToR) /specifikave teknike nga njësitë kërkuese për iniciim të procedurave sipas planifikimit. 2. Menaxhimi i Kontratave dhe zbatimi i tyre sipas obligimeve kontraktuale nga menaxherët dhe mbikëqyrësit e kontratave, me qëllim evitimin e rreziqeve financiare, pagesave të vonuara, rreziqeve operative dhe vonesa në realizim.	Ligji për Prokurimin Publik	6	7	42	1.1 Përgatitja e termave të referencës në përputhje me standardet dhe rregullat sipas ligjit të prokurimit publik dhe iniciimi i procedurave të prokurimit në pjesën e parë të vitit. 2. 1 Emërimi i menaxherëve profesional nga sektorët përkatës 2.2 Rritja e kontrollit nga mbikëqyrësi i	1.Njësitë kërkuese 2. Divizioni i Prokurimit, ZKA.	TM4 2026

								Mineraleve “Trepça” . 2.2.Inicimi i kërkesave zyrtare ndaj ndërmarrjes “Trepça” për sigurimin dhe pasurimin e fondit muzeal me kristale dhe minerale të reja.		
--	--	--	--	--	--	--	--	---	--	--